

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Jatra Mediterranean Industry" Sh.p.k.**

Sot, më datë 10/10/2022,

- **Z. Sidrit Pashako**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 22/04/2004, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me nr. BA5841933 dhe nr. Personal K40422047N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

- **Z. Lirim Ibraimi**, shtetas maqedonas, lindur në Tetovë, më 04/08/1976, banues në K. J. Pitu 82b, 1200 Tetovë, Maqedonia e Veriut, mbajtës i Pasaportës me nr. N0183668, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

- **Z. Jurgen Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur në Vorë, më 07/01/1992, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me nr. BF3996344 dhe nr. Personal J20107074P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Jatra Mediterranean Industry" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "Jatra Mediterranean Industry" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjia "Skenderbej", Rruga "Aleks Vini" Godina Nr.35, Kati 2, Zona Kadastrale 8523, Nr Pasurie 33/35, Elbasan.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.



#### NENI 4

##### OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Import - eksport i drurit. Përpunim dhe tregtim i produkteve dhe nënprodukteve të drurit dhe gjithcka tjetër që lidhet me të.
- Prodhimtari e parketit dhe shtëpive të parafabrikuara.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

#### NENI 5

##### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 1.000.000 Lekë (një milion) Lekë dhe është i përbërë nga tre kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Sidrit Pashako**, zotëron 1 kuotë, me 45% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 450.000 Lekë (katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 450.000 Lekë (katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Lirim Ibraimi**, zotëron 1 kuotë, me 45% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 450.000 Lekë (katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 450.000 Lekë (katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Jurgen Hoxha**, zotëron 1 kuotë, me 10% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 Lekë (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 Lekë (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.



## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Jurgen Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur në Vorë, më 07/01/1992, banues në rrugën "Ibrahim Ndroqi", ND 1, H.5, Ap.9, Njësia Administrative 9, Tiranë, mbajtës i Pasaportës me nr. BF3996344 dhe nr. Personal J20107074P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë 1 (një) vjecare, me të drejtë ri-emërimi.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Jurgen Hoxha** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.


### ORTAKET THEMELUES

**SIDRIT PASHAKO**



Sidrit Pashako

**LIRIM IBRAIMI**



**JURGEN HOXHA**

